



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 5875 Prot.

Tiranë, më 07.08.2014

URDHËR

Nr. 323, datë 07.08.2014

PËR

PILOTIMIN E KURRIKULËS SË RE NË INSTITUCIONET ARSIMORE
TË ARSIMIT BAZË NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 25 dhe 26 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Gjatë vitit shkollor 2014-2015, të pilotohet kurrikula e re në klasën përgatitore, klasën e parë dhe klasën e gjashtë, në ato institucione arsimore të arsimit bazë të përcaktuara nga Drejtoritë Arsimore Rajonale (sipas aneksit bashkëlidhur këtij Urdhri), miratuar me shkresën nr. 5739/1 prot., datë 05.08.2014 të ministrit të Arsimit dhe Sportit.
2. Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në MAS dhe IZhA të pajisin me Paketën e re Kurrikulare institucionet arsimore ku do të pilotohet kurrikula e re:
 - a) Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar e Republikës së Shqipërisë.
 - b) Korniza kurrikulare e arsimit parashkollor.
 - c) Kurrikula bërthamë për arsimin fillor (kl. 1-5).
 - d) Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët (kl. 6-9).
 - e) Programet mësimore.

- f) Metodologjia dhe instrumentet e vlerësimit të procesit mësimor, si dhe dokumentacionin shkollor, sipas modeleve të hartuara nga IZhA.
3. Drejtoritë e shkollave të krijojnë grupet për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë (GMV) së zbatimit të planit dhe të programeve të reja mësimore. GMV-të të drejtohen nga drejtori i shkollës dhe të kenë në përbërje nëndrejtorin e shkollës, koordinatorin e shkollës, koordinatorët e fushave kurrikulare dhe të gjithë mësuesit që përfshihen në pilotimin e kurrikulës së re.
 4. Grupet e monitorimit dhe të vlerësimit të cilësisë së zbatimit të planit dhe programeve mësimore të kurrikulës së re të mbledhen çdo muaj dhe sa herë gjykohet e nevojshme, në takime për të analizuar ecurinë e zbatimit të kurrikulës së re.
 5. Takimet e GVM-së, diskutimet dhe përfundimet e arritura të pasqyrohen në librin e procesverbaleve të mbledhjes së grupit. Libri i procesverbaleve dhe dokumentacioni që krijohet nga shkolla gjatë zbatimit të kurrikulës së re, të administrohen nga drejtori dhe të ruhen në shkollë.
 6. Dokumentacioni shkollor, libri i procesverbaleve dhe dokumentacioni i GVM-së (vendime, analiza, evidenca etj.), që krijohet nga shkolla gjatë zbatimit të kurrikulës së re, të jenë objekt inspektimi nga MAS-i dhe IShA-s dhe të trajtohen sipas Dispozitave Normative për sistemin arsimor parauniversitar.
 7. Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve:
 - a) Të hartojnë planin e posaçëm të veprimtarive për trajnimin, këshillimin, inspektimin, matjet dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së zbatimit të kurrikulës së re dhe për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në të gjitha institucionet arsimore.
 - b) Të raportojnë çdo 3 muaj në Drejtorinë e Arsimit Parauniversitar në MAS për veprimtaritë e realizuara në institucionet arsimore që zbatojnë kurrikulën e re.
 8. Drejtoritë arsimore rajonale dhe institucionet arsimore që zbatojnë kurrikulën e re, të planifikojnë veprimtaritë për informimin dhe njohjen e prindërve me risitë dhe përparësitë që mbart kurrrikula e re e sistemit arsimor parauniversitar.

9. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri: Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, IZhA, IShA, AKP, DAR-et dhe institucionet arsimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA



MINISTËR



Aneks

Lista e shkollave të përzgjedhura nga Drejtoritë Arsimore Rajonale për procesin e pilotimit

Nr.	DAR	Shkolla e përzgjedhur	
		Qytet	Fshat
1.	Tirana Qytet	“Edit’h Durham”	Shkolla 9-Vjeçare “At Zef Pllumi”
2.	Tirana Qark	Shkolla 9-Vjeçare “Vorë”	Shkolla 9-Vjeçare “17 Shkurti” – Qesarakë
3.	Durrës	“Kushtrimi Lirisë”	“Njazi Mastori”, Sukth i Ri
4.	Shkodër	Shkolla 9 Vjeçare “Ismail Qemali”	Shkolla 9 Vjeçare “Lush Kola” – Barbullush
5.	Lezhë	“Besëlidhja”	9-Vjeçare “Marash Gjoni” – Rrilë
6.	Kukës	“Riza Spahiu”	“Vehbi Shehu” – Bicaç
7.	Dibër	“Myslim Shehu”	Shkolla 9 – Vjeçare Maqellare
8.	Fier	“Andon Xoxa”	“Sotir Çapo”
9.	Vlorë	“Musa Cakerri”	Shkolla 9- Vjeçare “Selam Musai” – Babic E Madhe
10.	Berat	“Zihri Toska”	“Velabisht”
11.	Gjirokastrë	“Koto Hoxhi”	“Muhamet Gjollështa”
12.	Elbasan	“Naim Frashëri”	“Europa”
13.	Korçë	“Sevasti Qiriazhi”	“Tafil Rexhepi” – Pirc